



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TETO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr./Br. 140-144 /17
Dati/Datum, 05.07.2017
Republika e Kosovës
PRISHTINE - PRISTINA
Republika Kosova – Republic of Kosovo



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH. nr. 140/17
144/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 paragrafi 2, pika 2.16, nenit 106, nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej **Blerim Dina-Kryetar, Goran Milenković - Referues** dhe **Nuhi Paçarizi -Anëtar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 140/17, të parashtuar nga operatori ekonomik **“BESA SECURITY”** me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqësoj Granit Hasani, dhe sipas ankesës me nr. të protokollit 144/17, të parashtuar nga operatori ekonomik **“SECURITY CODE”** me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqësoj Esat Tahiri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës”**, me numër të prokurimit 90400/17/002/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në seancën e mbajtur me dt. 29 qershor 2017, mori këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorit ekonomik **“BESA SECURITY”** me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 140/17, dhe e **“SECURITY CODE”** me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 144/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës”**, me numër të prokurimit 90400/17/002/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- II. **Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, njoftim për dhënie të kontratës, për aktivitetit të prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës”**, me numër të prokurimit 90400/17/002/211, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim.

- III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.
- V. Operatorit ekonomik ankues **“BESA SECURITY”** me seli në Prishtinë dhe OE ankues **“SECURITY CODE”** me seli në Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i’u kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.
- VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Autoriteti Kontraktues– Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, më dt. 06 shkurt 2017, ka publikuar *Njoftim për Konratë*, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës”**, me numër të prokurimit 90400/17/002/211.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 4 (katër) operator ekonomik, ku sipas komisionit të vlerësimit të ofertave 2 (dy) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkua të në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për konratë, ndërsa 2 (dy) operator ekonomik nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkua të në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për konratë.

Autoriteti kontraktues më dt. 20 prill 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkësës për rishqyrtim, operatori ekonomik **“BESA SECURITY”** me seli në Prishtinë dhe OE ankues **“SECURITY CODE”** me seli në Prishtinë, në afatin e paraparë ligjor kanë parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Operatori ekonomik ankues "**BESA SECURITY**" me seli në Prishtinë, pretendon se autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës**", nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Operatori ekonomik ankues "**SECURITY CODE**" me seli në Prishtinë, pretendon se autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës**", ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 1, nën-paragrafin (vi) të paragrafit 6, nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së si dhe nenin 17 paragrafi 1 Rregullorja për Prokurimin Publik.

Ankesat e operatorëve ekonomik janë të afatëshme dhe të parashtruar nga ana e personave kompetent.

Ankesat janë pjesërisht të bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 29 maj 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me datën 12 qershor 2017, i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "Besa Security", vlerëson se pas analizimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues, sqarimeve shtese te kërkura nga AK-UP dhe sqarimeve tjera te kërkura nga eksperti, vije ne konkludim se operatrori ekonomik ankues nuk e përbush kriterin per qarkullim financiar prej 3,000,000.00 euro për sigurim fizik te dëshmuara me kontrata dhe referenca te përfunduara, sepse edhe pas sqarimeve verbale dhe dëshmive te sjellura ne forme fizike nuk mund ta dëshmoj ketë qarkullim. Po ashtu nuk ka sjellë dëshmitë sipas kërkesave te dosjes se tenderit, ka sjell referenca me data para se me përfundua shërbimet, mandej disa nga shërbimet janë te një natyre tjetër dhe përmes raporteve financiare te kontabilitetit te kompanisë assesi nuk mund te identifikohen shumat se për cilat shërbime janë, dhe si konstatim i përgjithshëm është se ky operator ekonomik nuk përbush ketë kriter. Prandaj, eksperti mendon se AK- UP-ja e ka eliminuar operatrorin ekonomik ankues sepse nuk ka përbush qarkullimin financiar .

Sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues “SECURITY CODE”, eksperti teknik duke u bazuar ne pretendimet e operartorit ekonomik ankues sqaron se nuk vëren se ka ndodh ndonjëra nga shkeljet e neneve te cekura ne ankese.Nëse analizojmë analizat financiare te dy operatorve ekonomik, OE fitues (Rojet e Nderit) dhe atij ankues (Security Code), eksperti konstaton se te dy operatoret ekonomik ne baze te kalkulimeve kane çmime te njëta për ore pune.

Prandaj, nëse marrim kalkulimet e OE fitues “Rojet e Nderit” , analiza financiare tregon se te dy operatoret ekonomik kane çmim te njëjtë për ore pune dhe at 2.15 euro, po ashtu po qe se marrim kalkulimet e OE ankues “Security Code”, analiza financiare tregon se te dy operatoret ekonomik kane çmim te njëjtë për ore pune dhe at 2.16 euro. Pra, operatori ekonomik ankues duke marre parasysh çmimin e uniformave për te dy operatoret ekonomik, qe ne ketë rast operatori ekonomik ankues ka çmimin prej 2.61 euro për uniforma ndërsa operatori ekonomik fitues ka çmimin prej 3.06 euro pretendon se do te duhej te jete me i lire se operatori ekonomik fitues, mirëpo pas kalkulimeve te ekspertit për këta dy operatoret ekonomik duke marre kalkulimet e njërit dhe tjetrit del se te dy operatoret ekonomik kane çmime te njëta për njësi.

Eksperti teknik sqaron se deri te kjo situate ka ardh për shkak se sipas LPP-së, konkretisht sipas Udhëzuesit Operativ-2016-A01_Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 18. Dosja e Tenderit, çmimi i ofertuar lejohet te shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore, çdo numër pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës. Ne rast se autoriteti kontrakutes lejon me shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë autoriteti kontraktues duhet te ceke këtë decidivisht ne dosje te tenderit.

Rrjedhimisht nga ato qe u ceken me larte ekspertet mendojnë se autoriteti kontraktues ka zbatuar ne përgjithësi dispozitat ligjore te LPP-së dhe nuk ka bere shkelje te dispozitave ligjore për te cilat pretendon OE ankues “Security Code”.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që të refuzoj ankesen me nr. 140/17 te OE “Besa Security” dhe ankesën me nr. 144/17 te OE “Security Code”, si të pa bazuara dhe njëkohësisht ti lejoj AK UP-Universiteti i Prishtinës te vazhdoj me tutje me procedurat e prokurimit.

Operatori ekonomik ankues **“BESA SECURITY”** me seli në Prishtinë dhe OE ankues **“SECURITY CODE”** me seli në Prishtinë , përmes parashtresës me shkrim të dt. 13 qershor 2017, njoftojnë panelin shqyrtues se nuk pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 12 qershor 2017.

Autroiteti kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes parashtresës me shkrim të dt. 13 qershori 2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 12 qershori 2017.

Me rastin e para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues "BESA SECURITY", ankesa e operatorit ekonomik "SECURITY CODE", raporti i eksperti shqyrtues/teknik i dt.12 qershori 2017, parashtresat e operatorëve ekonomik ankues dhe autoriteti kontraktues mbi raportin e ekspertit shqyrtues/teknik, si dhe deklaratat e palëve gjatë senaces dëgjimore.

Gjatë prezantimit në seancën dëgjimore përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues "BESA SECURITY" z.Hasani , deklaroj: kemi shikuar me vëmendje ekspertizën e eksprëve, dhe dosjen e tenderit nga AK-UP, duke pas në vëmendje faqet 17 dhe 20. Ekspertiza e ekspertit është tendencioze dhe vërehehet se duhet të ketë ngjashmëri të procesve të punës si në të kaluarën.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues sqaroj, që nga viti 2012 pas ankesës së "Besa Security" të adresuar dhe shqyrtuar në gjykatë në asnjë seancë nuk jemi dal fitues përkundër që në çdo tender "Besa Sercurity" merr pjesë.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në vazhdim të prezantimit theksoi: për njfotimin tuaj ne kemi shkërmbyer disa email me UP-në ku gjatë shqyrtimit të dosjes nga komision. Është emaili nga AK-UP lidhur me fitimin, ku z.Bajraktari ka kërkuar shkurtimisht që duke na njoftuar se janë në fazën e vlerësimit dhe ju kemi sjell analizën fiannaciare, mirëpo komisioni e ka të paqartë fitimin e parashikuar 200.00 €, dhe ka kërkuar që fitimi parashikuar 200.00€, ta dij a është mujor apo vjetor.

Kjo email është datës 05.04.2017 në ora 11.34, ndërsa është kërkuar përgjigje ti kthehet në ora 14.00 të të njëjtës ditë.

Me qenë se emaili më është dërguar mua dhe unë kam qenë jashtë vendit, ka qenë mesazhi automatik që i është kthyer AK-së, dhe në email ju kam spjeguar këtë, mirëpo i jemi përgjigjur se ësthë i dukshëm dhe i kuart kalkulimi i dhënë dhe mënyre si është parashikuar prej kompanisë tonë.

Pastaj kemi marr emailin tjetër pas orës 2, ku na është dhënë kohë përgjigje deri me 11.04.2017, dhe janë kërkuar edhe disa kontrata –sqariem rreth kontratave për datën e nënshkrimit dhe të përbylljes.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi se “Besa Security” ka kthyer përgjigje dhe përkundër përgjigjës të qartë prej nesh si për analizë financiare si për konratatat e refereuara, ne kemi pranuar shkresën për eliminim nga procesi i vlerësimit të ofertave. Siç mund të shihini arsyen e elimiimit tonë e që jemi OE më i lirë në këtë tender, është bërë fare leht prej AK-së por edhe nga eksperti shqyrtyues përmes ekspertit teknik të cilët janë kapur në afate të kotnratave dhe mënyren si ne i kemi prezantuar ato duke konkluduar se “Besa Security” nuk ka qarkullim 3 milion euro për 2014-2015-2016.

Në kërkesën e dosjes faqe 17, shihet që kërkohet që OE të kenë kotnrrata për shërbime të sigurimit në vlerë 3 milion për tri vite, për të dëshmuar se OE është i afatë për të menaxhaur pronat e UP-së, mirëpo esenca është dëshmija e qarkullimit e cila nënkupton mundësinë e menaxhimit të këtij projekti.

Përkundër faktit qe ne kemi njofuar AK-në se vetëm me pesë kontrata ka mbi 3.2 milion euro qarkullim, të cilëve “Besa Security“ i ofron shërbime nga viti 2012, duke kontraktues është munduar të kapet tek fjalia e thurur nga ne, dhe nuk është munduar të arrij qëllimin e kësaj pike, nëse vërtet “Besa Security“ ka qarkullim apo jo. Nëse është e vullnetit të verifikohet nëse “Besa Security“ ka kapacitete të mjaftueshme, mund të kërkohet kontrata shtesë që kemi përgaditur, mirëpo nuk na janë pranuar nga eksperti teknik, se ato mund ti prezantoni vetëm në seancë nëse ka vullnet paneli në bëzë të nenit 72 të LPP. OE “Besa Security“ ka prezantuar që sipas formularit të deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimeve të korporatave vetëm për 2016 ne tejkalojmë shumën prej 3 milion euro.

Sa i përket pjesës financiare, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi, përkundër që në ankesë në OSHP e kemi sqaruar çështjen e kontratave që është thënë nga AK-së si pikë, ne kemi elaboruar në detaje pjesën e çmimit pasi jemi operatri ekonomik më i lirë dhe i përgjegjshëm.

Për pjesën e çmimit eksperti teknik vetëm ka marr info rreth mënyrës së kalkulimit nga ana e jonë dhe edhe pse është ndar i bindur gjatë takimit në zyret e tij ku kemi dërguar kontrata dhe sqarimet shtesë, se kalkulimi jonë është në rregull, nuk e ka përmendur fare në ekspertizë këtë çështje. Siç ka potencuar “Besa Security“, çmimi është bazuar në informata detale të dhëna në aneksin 1, me cilin rast ka 7 pika që nuk kanë orë të natës fare, dhe punëtorëve i janë kalkuluar pushimet vjetore siaps ligjit, dhe kalkulimeve të kontabilitetit në katër javë po 28 ditë, dhe jo 31 ditë siq e kanë bërë OE-të tjerë.

Shpresojmë që paneli të veproj me drejtësi duke marr në vlerësim kontratat tona dhe mënyrë e kalkulimit të çmimit, dhe ta kthej porcesin në Rivlerësim duke mos pas nevoj lënda të shkoj në organet e drejtësisë.

Në fjalë përfundimtare z.Hasani deklaroj: kontratat e kërkuara janë të natyrës së njëjt, dhe pse eksperti nuk ka dhënë mendimin për pikën 72 të LPP-së, që autoriteti kontraktues a është dashtë të kërkoj prej nesh informata shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, kur e kemi trajtuar këtë çështje gjatë sqarimit tonë.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatori ekonomik ankues kërkojm nga paneli shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlerësim, pasi operatori ekonomik i rekomanduar është i papërgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancën dëgimore përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues “SECURITY CODE” z.Tahiri deklaroj: kriteri i pagës 250.00€, ky ka qenë kriter shumë i kuart, sipas analizës fiancnaire. Eksperti fare nuk ka hyrë në pretendime ankimore të ankesës tonë, por në mënyrë mjeshtrore i ka ikur pikat e ankesës, duke bërë ekspertizë jashtë çdo pretendimi ankimorë që me këtë ve në lajthitje anëtarët e panelit dhe të marrin si drejtë ekspertzië.

Eksperti e ka orientuar eksperizën e me qëllim të favorizimit të OE fitues “Rojet e Nderit” duke na barazuar çmimin e ofertës, që në fund të përdor nene të caktruara nga UOPP, që cili dorëzon i parë ofertën ai fiton. Po ashtu në favor të OE fitues duke i ikur çmimit të ofertës dhe duke hyrë në analizë financiare e cila ka qenë kërkesë e AK-së pér ta kutptuar se si kemi ardh deri te ky çmim i ofertës.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në vazhdim të prezantimit theksoi: pika anakesës tonë dhe ankimimi jonë ka qenë se operatori ekonomik fitues nuk e ka përbushur kriterin e pagës, që ka qenë kusht i AK-së në dosje të tenderit. Këtë gabim OE “Rojet e Nderit” e ka bërë vetëm me ambicjen që të dal më i lirë në çmim, duke plotësuar kriterin e dosejs së kriterin çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Me plotë përgjegjësi e themë këtë dhe dëshmoj me fakt se ne procesin e hapjes së tenderit ku shihet qartazi dallimi i ofertave mes të “Rojeve të Nderit” dhe “Security Code” dhe nuk qëndron fakti i ofertës së njëjt apo ai tre apo katër numrave pas presjes dhjetore, por faktikisht në ofertën tonë janë dy numra pas presjes dhjetore. Dallimi me ofertës së “Rojeve të Nderit” dhe “Security Code” është 2,856.96€, dhe nuk qëndron fakti se jemi të barabartë në ofertim.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues potenco se kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë kriteri i përbushjes së pagës 250.00€ bruto, çdo here sipas ATK-së dhe ligjit në fuqi 250.00€ bruto nënkuption plus 5% trusti pensional që duhet OE ti paguaj punëtorit, sipas analizës financiare OE “Rojet e Nderit”, fordin e orëve të caktuar prej AK-së 174 orë, e ka pjestuar 250 me 174 orë, që në këtë rast fare nuk ka kalkular 5% trustin pensional. Në këtë rast ora e ditës së OE “Rojeve të Nderit” është 1.4367, kurse kur i shtohet trusti prej 5% ora ditës del 1.5086. Defekti i kalkuimeve të OE-ve është tek kjo pikë, në këtë rast është shkel neni 7 i LPP-së.

Përfaqësuesi i autoriteti kontraktues z. Bajraktari gjatë senacës dëgjimore deklaroj: ne kemi kërkuar në dosje që paga bazë bruto të jetë 250.00 euro, mirëpo të paguhen orët e natës, festat zyrtare dhe pushimi vjetor, si dhe uniformat, që të mos obligohen puëntorët të blejnë uniforma. Në çmimin e tyre “Besa Security” nuk mundet të ofroj pagë 250.00€ me gjitha këto kritere percjellëse. Për OE “Security Code”, disa here prej tre OE-ve kemi kërkaur sqarime. Kërkesat e pagës minimale përbushen prej OE “Rojeve të Nderit” dhe prej OE “Security Code”.

Eksperti teknik z.Mulaj ne seancën dëgjimore deklaroj: Sa i përket ankesës së OE “Besa Secutiry”, kam cek edhe në sqarimin numër 2, se ky operator ekonomik nuk i është referuar fare dispozitave të LPP-së dhe asnjë nenit të caktuar se cilat janë shkeljet e ndonjë nenit që e kanë dëmtuar në këtë rast.

Sa i pëket qarkullimit te kërkesat mbi kapacitetet teknik financiarë, OE duhet të dëshmoj se në tri vitet e fundit 2014-2015-2016 ka pas qarkullim me kotnrata (të përfunduara 2014-2015-2016) përsigurim fizik 3 milion euro. Si dëshmi janë kërkaur kopjet e kontratave së bashku me referenca përkatëse.

Për tu sqaruar edhe më shumë, kam kërkuar sqarime shtesë prej OE “Besa Security” lidhur me kontratat e prezantauara në ofertë financiare, dhe për secilen kontratë veç e veç kam dhënë sqarim, dhe duke marr për bazë periudhën 2014-2015-2016, ky operatror ekonomik sipas kérkesave të dosjes nuk përbushë kriterin prej 3 milion e euro qarkullim financiarë. Problemi po ashtu qëndron edhe te refencat ku thuajse gjitha janë lëshuara para kohe-para se të përfundoj shërbimi i caktuar. OE “Besa Security” nuk plotëson kriterin për qarkullim. Çështjen e pagës nuk e kam shqytyuar pasi ka qenë OE i eliminuar në atë fazë.

Lidhur ankesën e OE “Security Code”, eksperti teknik theksoi: këtu kam sqaruar kalkulimet duke marrë për bazë LPP-në, konkretisht UOPP 2016A-01 neni 18 , dosja tenderit, ku thotë çmimi i ofertuar të shënohet me maksimum dy numra pas pikës dhjetore, çdo numër pas numrit të dytë nuk do merret për

bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Kur bëhen kalkulimet duke marr për bazë këtë pikë të LPP-së dhe UOPP, çmimet e OE “Rojet e Nderit” dhe OE “Security Cod” barazohen.

Në rastin kur dy oferta janë të barabarta me çmim, neni 40.9 e sqaron autoriteti kontraktues pranon dy apo më shumë ofertat të përgjegjshme me çmime të njëjtë, nuk vlenë votimi i anëtarëve të komisionit por përzgjedhja bëhet sipas kohës së dorëzimit të ofertës, operatori ekonomik që ka dorëzua ofertën i pari shpallet fitues.

Eksperti teknik ne fund të prezantimit theksoi, duke u bauzar në këtë që u cekën më lart kemi rekomanduar panelin të refuzohen ankesat dhe të lejohet autoritetit kontraktues të vazhdoj me procedura të prokurimit.

Përfaqësusi OE “Rojet e Nderit” z.Hasani, në seancën dëgjimore deklaroj: çmimi jonë ka ardh në bazë të aplikimeve të ligjeve në fuqi dhe kushteve të AK-së, ku gjitha kushtet e pagës të kërkua prej AK-së janë përputhje me sistemet e ATK-së. Pajtohem i plotësish me komisionin e AK-së dhe me ekspertin shqyrtues/teknik. Dua të lidhem me një detaj, që ka mundësi që i ka ikur “Security Code”, ku janë 7 pika që punohet vetëm ditën dhe këtu nuk është dashtë të kalkulohet me orë të natës. Për ndryshe siç kemi cek në analizë financiare decidivisht e keni çdo detal të analizës dhe qëndrojmë pas me gjitha elementet që kemi vendos në analizë.

Anëtari i panelit z.Pacarizi, pyeti ekspertin teknik se a qendron pretendimi i operatorit ekonomik se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka kalkuluar 5% për trust pensional, në përgjigje z.Mulaj deklaroj: Po, OE i rekomanduar e ka të kalkuluar 5% për trust pensional.

Paneli shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke pasur parasysh deklarata e palëve gjatë seances dëgimore, konstaton se autoriteti kontraktues më qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, është i obliguar që në harmoni me nenin 7 paragrafi 1 të LPP-së ti trajtojë të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë dhe të bëjë analizat fininaciare të çmimit të ofruar nga secili operator ekonomik ofertues a e mbulojnë apo jo kërkesën e dosjes së tenderit për pagën 250.00€.

Po ashtu paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësim me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike se operatori ekonomik ankues “BESA SECURITY”, a plotëson kërkesen e specifikuar ne nenin e 8.1 lidhur me nenin 8.2 të FTD-së si dhe me dëshmit e ofruar nga ky operator ekonomik lidhur me kërkesën në fjalë, është dashur që nga operatori ekonomik i ankues të kërkoj sqarime konform nenit 72 paragrafi 2 të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues/teknike, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorëve ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues “BESA SECURITY”, parashtresës së operatorit ekonomik ankues “SECURITY CODE” , parashtresës së autoritetit kontraktues, sqarimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues/teknik gjatë seancës dëgjimore, vie në përfundim që AK duhet që konfromë nenit 72 të LPP-së, të vërtetoj se OE-të a i plotësojn kërkesat specifikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 ekzemplar – OE “BESA SECURITY” Prishtinë
- 1x1 ekzemplar – OE “SECURITY CODE” Prishtinë
- 1x1 ekzemplar - AK Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”
- 1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së
- 1x1 ekzamplar- Për publikim në ëeb.